
PHILOSOPHICAL ASPECTS OF MODERNISM AND GLOBALIZATION: ZYGMUNT BAUMAN AND OTHERS

Amir Mustafai

South East European University, Republic of Macedonia, a.mustafai@seeu.edu.mk

Abstract: In the public discourse and academic opinions often we happen to face with the terms of modernism, globalization, global world, global economy, global village, and similar. In different fields these terms, and especially the globalization, has got different meanings, each of which with a common denominator that represents the character of generalizing a process, its elements and principles of which cooperate as a whole. In one way or another the question of the globalization and its effects on society, economics, science and technology has provided the right place in studying social, economic, technical, scientific or medical fields, however – globalization gained its place also in the field of philosophy. In philosophy the theme of globalization has received a special interest. While in other areas, globalization was to take into account generalizing character, in the field of philosophy, globalization takes distinctive character, i.e., the process of globalization and its effect into human being itself. The human being according to the recent philosophers, in influence of globalizing effects, has undergone some changes in the psychological, aesthetic, epistemological and ontological domains. Here, of course, there are many aspects to analyze, however what interests most recent philosophers is the impacts of globalization in the well-being of the human being itself. There are various theories, sometimes contradictory and sometimes compatible with each other, however what makes impressions in this discourse is that the process of globalization has shaken the basics of how human being is defined. In this context, one of the 20th century's most famous sociologists and philosophers, Zygmunt Bauman, poses a lot of doubts about whether globalization is compatible with human nature or does not, or if the degree of alienation will transform human being into *something else*. In extensive analysis of the latter, Bauman uses notions such as modern fever, panoptic syndrome, synoptic effect, space-wars, tourists and vagabonds etc., demanding to describe the essential human involvement in the globalization process. In addition, Bauman in the process of globalization notices the compression of time – as he deposits the term – which creates the so-called new global social strata, which dismantle the classical sociological structures, as we have previously referred to in social sciences. The latter, and other theories, will be analyzed separately in our paper that seeks to see globalization through another prism – such as philosophy does.

Keywords: Globalization, Modernism, decomposing time/space, panopticon versus synopticon, Zygmunt Bauman.

**ASPEKTET FILOZOFIKE TË MODERNIZMIT DHE GLOBALIZIMIT:
ZYGMUNT BAUMAN DHE TË TJERËT**

Amir Mustafai

Universiteti i Evropës Juglindore, a.mustafai@seeu.edu.mk

Abstrakti: Shpesh në diskursin publik dhe në opinionet akademike ndeshemi në përdorim të shumtë të termeve si modernizmi, globalizimi, bota globale, ekonomia globale, katundi global, dhe të ngjashme. Në fusha të ndryshme këto terme, dhe në veçanti globalizimi, ka marrë kuptime të ndryshme me një emërues të përbashkët që përfaqëson karakterine përgjithësimi të një procesi, elementesh po edhe principesh të cilat bashkëdyzohen si një tërësi. Në njërin ose tjerin mënyrë çështja e Globalizimit dhe efekteve të tij në shoqëri, ekonomi, shkencë dhe teknologji, ka siguruar vendin e duhur në studimin e fushave sociale, ekonomike, teknike, shkencore apo medicinale, por mbi të gjitha edhe të fushës së filozofisë. Në filozofi tema e globalizimit ka marrë një interesim të veçantë. Derisa në fushat tjera interesimi mbi globalizimin ishte të marrë në konsideratë karakterin përgjithësues, në fushën e filozofisë, globalizimi merr karakter veçantues, që dëth, procesi i globalizimit nën influencën që bën në vetë qenien njerëzore. Qenia njerëzore sipas filozofëve që do të prezantojë punimi ynë, pas paraqitjes së efektit globalizues, ka pësuar disa ndryshime në vetë dimensionin etik, psikologjik, estetik, epistemologjik dhe ontologjik. Këtu natyrisht ka shumë aspekte për tu menduar, por ajo që më së shumti iu interesojnë filozofëve bashkëkohor janë ndikimet e globalizimit në vetë mbarëvajtjen e qenies njerëzore. Në këtë kuptim teori të ndryshme, herë në kundërshti dhe herë në pajtueshmëri me njëra tjerën, kanë detektuar që në fillim se globalizimi mbi të gjitha ka tronditur bazat e asaj se si njeriu është i definuar deri më sot. Në këtë kontekst, njëri nga

sociologët dhe filozofët e shekullit të 20-të, Zygmunt Bauman, do të parashtron para vetes shumë dyshime nëse globalizimi është në pajtueshmëri me natyrën e njeriut ose në mos e ngarkon atë deri në atë shkallë të tëhuajësimit të qenies dhe shndërrimit në diçka tjetër. Në analizë të gjërë të kësaj të fundit, Bauman do të përdor nocione si fluditeti modern, sindromën panoptikon, efektin synoptikon, space-wars, turistët dhe vagabodët etj, me qëllim që përshkrimin të involvimit qenësor të njeriut në procesin e globalizimit. Përveçkësaj, Bauman në procesin e globalizimit do të shoh kompresimin e kohës – siç e vë në pah ai- i cila krijon tëa.q.strata të globalizimit, të cilat shpërbëjnë strukturat klasike sociologjike, siç jemi referuar më parë në shkenca të ndryshme sociale. Këto të fundit, dhe teoritë e tjera, do të analizohen veçmas në punimin tonë i cili synon të shoh globalizimin përmes një prizmi tjetër – siç është ajo e filozofisë.

Fjalët kyçe: Globalizimi, modernizmi, dekompozimi i kohës dhe hapësirës, panoptikon kundrejt sinoptikon, Zygmunt Bauman.

1. HYRJE: ZYGMUNT BAUMAN, MODERNIZMI DHE GLOBALIZMI

Zygmunt Bauman konsiderohet si një ndër intelektualët më të shquar të kohës moderne. Opusi i tij përbën një lepezë të gjërë të studimit të fushës sociale, duke u nisur prej sociologjisë, filozofisë, psikologjisë, ideologjisë, politikës dhe për të përfunduar në analiza të thella mbi fenomenet sociale dhe moderne të kohës. Bauman përveç tjerash shquhet si njohës i thellë i modernitetit, modernizmit, procesit modernizues dhe impikimeve sociale që lidhen po me këto procese. Ai është në serinë e sociologëve dhe filozofëve tjerë (Ulrich Beck, Scot Lash, Jürgen Habermas, Anthony Giddens) që hetuan natyën dikotomike të modernitetit dhe modernizmit dhe të cilët alarumuan për masat kundrejt efektit kundërthënës të procesit modernizues. Kur flitet për këtë natyrë dikotomike s`do mend se lista e autorëve që i kanë paraprirë këtij qëndrimi është i gjatë dhe shkon deri në filltet e para të paraqitjes së filozofisë moderne pas-Kantiane. Biles, rrënjët e këtij debati mbi dikotominë e modernizmit i gjejmë edhe në diskutimet mbi arsyen dhe natyrën e saj, e shtuar në mënyrë detajore nga vetë Immanuel Kant.

Immanuel Kant, si një proponent i flaktë i modernizmit parimisht distinkcionoi dy naturat e arsyes, i cili dallim u inauguroi si filltet e para të filozofisë moderne. Dy naturat e arsyes të ndara nga Kanti si *Verstand* dhe *Vernunft* përbëjnë dy natyrat që përbëjnë procesin e të menduarit njerëzor. Për Kant validimi i të vërtetës ndodh brenda subjektit, kurse mendimi i ndihmon në përkapjen e këtyre të vërtetave, por, procesi i të menduarit nuk kishte vetëm këtë funksion te Kant. Racionaliteti sipas Kant përbën edhe për një natyrë jo-abstrakte të procesit të të menduarit, që përveç konceptimit ka edhe procesin reflektues. Siç vëren edhe studjuesja Anxhaku, `racionaliteti që kuptuar jo vetëm si një skemë e qëndrueshme konceptesh për të sistematizuar dijen sipas disa parimeve më të larta të mundshme, por edhe si mundësi e shqyrtimit të vetvetes në mënyrë kritike në dy pjesët përbërëse të rij, *Verstand* dhe *Vernunft*¹⁸⁹. Ndërsa e para morri karakterin e arsyes operative, e dyta nga Kanti u kuptua si arsyeja kritike, ose ajo e nocioneve të pastra. Debati mbi këtë distinkcionim është i gjatë, i cili vazhdon së rrahuri gjërësisht në vetë Filozofinë Kontinentale të shekullit të 20të, ndërsa ne për interesa të studimit tonë marrim parasysh vetëm lindjen e e këtij diskursi në filozofinë moderne, i cili debat do të natyralizon edhe vetë procesin e modernizmit dhe modernitetit si të tillë.

Sidoqoftë, diskutimi i mësipërm mbi natyrën e arsyes dhe shfaqjes së modernizmit, na bën me dije për situatën komplekse me të cilën qasja mbi modernizmin si të tillë dhe ndikimin e tij në shoqëri, është e nduarndurshme, në veçanti në kushtet e sotme të globalizimit. Lidhur me këtë, Bauman si një përfaqësues i Shkollës së Frankfurtit do të angazhohet në formë holistike për ta demistifikuar natyrën e modernizmit dhe efekteve globale në shoqëri, dhe për më shumë të na ekspozojë naryrën e vërtetë të karakterit dynatyor të procesit të globalizimit në vetë qenien e njeriut. Bauman nisat nga ideja se historia moderne institucionale dhe zhvillimi shoqëroro-kulturore nuk ka ndryshime qenësore në kuptim të ristrukturimit të ri institucional dhe kulturor në botë, por me një ngritje (apo lartësim) të nivelit të modernizmit në një instancë tjetër zhvillimore, por asesi tjetërsishme. Këtu, Bauman (dhe autorë tjerë si Scot Lash, Anthony Giddens, Jurgen Habermas) e hedhin poshtë tezën se zhvillimi shoqëror ka kaluar në paradigma të reja të aq. postmoderne (siç e vë në pah J.F. Lyotard, etj), ku humbja në besimin e metanarrativave (term i Lyotard), ka përhumbur besimin në vërtetësinë e të vërtetave të shtresuara përgjatë kohës moderne¹⁹⁰. Andaj kundrejt një humbjeje të tillë, koha moderne i dorëzohet asaj të ristrukturuarës, diçkaje të resë – ose *postmodernes*. Përkundër Lyotard dhe proponentëve tjerë të postmodernës, Bauman për të emëruar ndryshimet rapide në zhvillimin e mbarë shoqëror dhe atë shkencorë, ai propozon termin *moderniteti likuid*, i cili nënjë mënyrë më të thuktë e shpreh gjendjen shoqërore-sheknore dhe zhvillimin kulturor-institucional në botë – në veçanti në kushtet e sotme

¹⁸⁹ Anxhaku A. *Arsyeja ndermjet mitit, iluminizmit dhe refleksionit kritik*, Tiranë:Maluka (2007).

¹⁹⁰ Lyotard J.F. *Kushti Postmodern – Raport mbi Situatën e Dijes*, Tiranë: ISP & Edlora (2011).

tëglobalizimit¹⁹¹. Për më tepër, Bauman lidhur me likuiditetin modern flet për një astrukturim të klasave shoqërore ku njerëzit i ndërrojnë klasat, rolet, jetët, bindjet etj, sa që krijohet përshtypja se asgjë nuk ka stabilitet ontik social, por përkundër gjithçka likuidizohet në diçka tjetër, ose siç e quan ai, ajo e shoqërisë nomade. Ai në mes tjerash ai do të karakterizon disa fenomene shoqërore si të reja në kohët e globalizimit, siç ajo e kompresimit të kohës, hapësirës, ideologjisë, estetikës së qyteteve moderne, distinkcioneve sociale, të cilat fenomene do të shtrihen studime serioze në fushën e sociologjisë dhe filozofisë. Bauman lidhur me njeriun modern merr parasysh edhe karakterin paranojak dhe ambivalent të qenies njerëzore të kohëve moderne, deri në atë shkallë që studimi i tij mbi konsekuencat përgjatë procesit globalizues kontemplotet në formën holisitke, gjithpërfshirëse shoqërore, ekonomike, institucionale, estetike, politike dhe atë ideologjike.

2. ZYGMUNT BAUMAN NË DEBATIN PRO-ET-CONTRA MBI GLOBALIZIMIN

Përgjatë debatit mbi globalizimin dhe ndikimin nëmbarrëshoqërinë, studjuesit në përgjithësi ndahen në dy tabore – ato të cilët përkrahin globalizimin si proces përgjithësues të dimensioneve shoqërore, politike dhe shkencore, dhe atyre kritikëve të cilët globalizimin e shohin si masë gllabëruese e sistemeve ekzistuese shoqërore dhe së këndejmi efektin e biejnë në zhvatjen, alientimin dhe alternimin e qenies njerëzore. Kategoria e parë, i prirret rezultateve pozitive të procesit globalizues, në kuptimin politik, ekonomik, edhe atë social (siç janë Taylor, Weber, Barlett, Ghoshar), ndërsa të dytët, përkundrazi alarmojnë situata jo të qëndrueshme sa i përket ndryshimeve sociale dhe politikë-ekonomike të procesit globalizues (siç janë Brecher, Costello, Korten, Berger etj).

Përveç syresh, ekzistojnë poashtu edhe kategori tjera të studjuesve të shkencave sociale të cilët besojnë se fenomeni i globalizimit do të duhej të analizohet në një qasje metodologjike me qëllim të përshkrimit të saktë të strukturës të fenomenit të globalizimit duke mos anashkuar edhe aspektet epistemologjike ose ontologjike të tij (siç te J.A. Scholte). Dy dimensionet e fundit kanë të bëjnë me analizën kryekëput filozofike të fenomenit të globalizimit. Ndërsa te e para – pra aspekti epistemologjik – shohim mënyrën se duhet ditur globalizimin, te e dyta – pra ontologjia – ndeshemi me pikëpyetjen e natyrës së globalizimit. Në këtë simetri, Bauman i është përkushtuar fenomenit të globalizimit në vetë natyrën dhe ndikimin e tij në shoqëri, në veçanti në shkrimin e tij mbi konsekuencat njerëzore të globalizimit¹⁹². Bauman, në këtë të fundit, shprehet skeptik në premtimet e globalizimit dhe efektet e dobishme në shoqëri, si dhe tërheq vërejtjen në paraqitjen e fenomenit të alienimit, kompresimit, ideologjizimit etj, te të cilat punimi ynë do t'ju kthehet pak më poshtë.

Duke analizuar në kontekste më të gjëra, globalizimi është emëruar më tej varësisht natyrës ndikuese në shoqëri. Për disa autorë¹⁹³, globalizimi nuk paraqet gjë tjetër vetëmse ndërkomëtarizimin e proceseve shoqërore, duke siguruar kështu rrjedhën e lirë të kapitalit (siç është paraqitur te Hrust dhe Thomson). Në kuptim të përafërt me këtë më sipër, Sander e sheh globalizimin si projekt liberal të botës, ku mundësohet funksionimi më i denjë i ekonomisë së lirë. Disa autorë të tjerë si Raiser dhe Davis në këtë proces të përgjithësimit verëjnë natyrën universalizuese dhe sintezën kulturore planetare të njerëzimit. Ndërsa marrë si vlerë e nisur me baza perëndimore, Spybey dhe Taylor, fenomenin e globalizimit e marrin si projekt perëndimor duke mundësuar kështu modernizimin e shpejtë të shoqërisë botërore. Të gjitha këto më lart marrin përsipër analizën mbi globalizimin në kontekstë më shumti të *jashme*, që për dallim nga Zygmunt Bauman i cili në paraqitjen e globalizimit i merr në konsideratë edhe ridimensionimet e *brendshme* të shoqërisë. Ai në të vëren ndryshime në standardet kohore dhe hapësirore të njeriut, deri në shkallë të ndryshimit të “operativitetit” të dy kategorive në vetë organizimin e jetës së njeriut.

Për ndryshimin e standradit kohor dhe kompresimin e së njëjtës në jetën shoqërore punimi ynë shërbehet me termin “re-temporalizim” kurse për kompresimin dhe zgjerimin hapësiror –termin “re-spatializim”, të cilat efekte të brendshme përmbajnë konsekuenca të paparashikueshme të qenies njerëzore. Që të dy format e operimit të këtyre ridimensionimeve të qenies së njeriut përbëjnë shtyrjen e kufijve të kategorive themelore të jetës njerëzore, si ato të kohës dhe hapësirës. Këto pasoja dhe të tjera që përshkruan Bauman në studimin e tij mbi konsekuencat e globalizimit jep me dije për frymën mbisunduese skeptiketë tij lidhur me premtimet e shumta të globalizimit për internacionalizim, liberalizim, ekonomi globale, treg të lirë mallrash dhe të ngjashme, siç i prezantua shkurtazi më lartë. Bauman krijon dyshime mbi suksesin e integritit globalist me të cilën krijohen struktura të reja klasore që minojnë kohezionin social dhe stratifikime të caktuara sociale, që Bauman i quan “Turistët” dhe “Vagabondët”, ose endacakët modern.

¹⁹¹ Bauman, Z. *Liquid Modernity*, Cambridge, Polity Press, (2000)

¹⁹² Bauman, Z. *Globalization: Human Consequences*, Oxford, Polity Press (1998)

¹⁹³ Për të gjitha vështrimet e autorëve të ndryshëm lidhur me natyrën e globalizimit të përshkruara në këtë paragraf janë të marra nga listimi i bërë nga J. A. Scholte në librin:

Scholte, J.A. *Globalization – A Critical Introduction* (2nd Edition), NY, Palgrave Macmillan (2005)

Për të dy kategoritë sociale, do të kthehemi përsëri më poshtë, por ajo që mbetet të theksohet është se Bauman lidhur me ndikimet e globalizmit, alarmon për gjendjen mobile të shoqërive, i cili mobilitet nuk është në terme të thjeshta fizike, porse edhe në kategoritë abstrakte të jetës njerëzore, si lëvizja dhe kompresimi kohor, hapësiror, vleror, gjinor, identitar, që në instancë të fundit, trondit themelet ontologjike të vetë qenies njerëzore. Një tronditjeje të tillë i pason gjendja *likuide*, siç e quan Bauman, ku të gjitha premisat tradicionale të rrjeteve dhe strukturave sociale dhe qenies njerëzore si të tilla, marrin karakter fluid, ose shndërrohen në diçka tjetër dhe të tjetërsishme, alterim ky deri në pakufishmëri.

3. ZHVENDOSJET PARADIMGATIKE TE KOHËS DHE HAPËSIRËS TE BAUMAN: PANOPTIKON VERSUS SINOPTIKON

Nëparaqitjen tonë më lartë lidhur me ritjetërsimin e kategorive abstrakte nga Bauman, dhe riatdhetësimin e tij mbi kohën dhe hapësirën, përmendëm se Bauman në procesin globalizues parashikon ndryshime rrënjësore lidhur me atë se si qenia njëjërëzore do të shtresohet në nivelet më abstrakte të saja. Folur më konkretisht, koha dhe hapësira paraqesin interesimin e thellë të fenomenit të jetesës njerëzore që nga antika. Definicionet lidhur me to janë të shumta kurse lidhja e jetës së njeriut me njëjtat poashtu është thelluar në analiza të pafundme edhe në shkencat e tjera. Do të na mjaftonte të sjellim këtu vetëm veprën e Aristotelit mbi “Kategoritë” për të rifreskuar kujtimin mbi kategoritë e *kohës* dhe *hapësirës*, të cilat te Aristoteli janë të vendosura si njësi të veçanta të pa-kompozicionuar dhe të pa-strukturuar. Këto të fundit, si të tilla mbesin si universaljet filozofike dhe janë vetëm subjekt i një predikati ose propozicioni të caktuar. Që të dy kaegoritë dhe shtatë të tjera (përveç substancës) janë bazat e çdo emërimi qënësor te “Organoni” i Aristotelit¹⁹⁴. Një nga kushtet e vetme të emërimit dhe definimit të substancës, te Aristoteli janë edhe koha dhe hapësira. Natyrisht kategoritë e Aristotelit më vonë marrin rolin e një *vademezum-i* për synimet e çdo lloj definimi të Qenies në analizat e mëpastajme të filozofëve pas-aristotelian. Për më shumë, këto kategori, meqë shprehin një nga bazat e qenësisë, ne në këtë punim e marrim vetëm si shembull sa për të ilustruar kërshtërinë e kahmotshme të filozofëve për të kontempluar mbi vërtetësinë e fenomeneve ose gjësendeve që mbajnë rol crucial në vetë definimin e qenies dhe të vërtetave të saj.

Kategorizimi dhe definimi i mësipërm i Aristotelit natyrisht nuk është rast i vetëm mbi filozofinë e kohës dhe hapësirës. Në diskutimet e mëvonshme *koha* dhe *hapësira* paraqesin fenomene të veçanta dhe jo universalje të pa-kompozicionuara të qenësisë së gjësëndeve apo qenies. Mjaton të përmendim ekspozenë e kësaj lënde mbi filozofinë e kohës dhe hapësirës së filozofit iranian të shekullit të 16-të Mir Damad, për të rimenduar thellësisht mbi realitetin metafizik të kategorizimit kohor dhe hapësiror. Mir Damad në veprën e tij “Prafullimat (*al-Kababat*)” jep përgjigje ultimative mbi kohën, origjinën, pranishmërinë, epistemën e kohës, ontikën e hapësirës, etj, të cilat bashkëdyzime nocionesh përbëjnë një nga diskutimet më lukrative në historinë e diskursit filozofik mbi kohën dhe hapësirën.

Sidiqoftë, historia e diskursit filozofik mbi natyrën e këtyre kategorive është ethellë dhe i përket një fushe të veçantë (siç është metafizika), ndërsa ne në këtë punim i sulemi vetëm kontekstit të rritjesimit ontologjik të kategorive të kohës dhe hapësirës në fushën sociale të jetesës njerëzore. Në këtë kuptim, Bauman dhe proponetë të tjerë të filozofisë sociale, japin disa kuptime sindromës së riatdhetësimin të kuptimësive mbi kohën dhe hapësirën, definicione këto që ndërrojnë kursin e kuptimësive të shtresuara të kategorive të lartpërmendura në filozofinë sociale. Për më tepër, këto rishtrësime kuptimore janë të përpunuara edhe nga autorë të tjerë të a.q. post-modern, si Foucault, Derrida dhe Lyotard të cilët unanimisht pajtohen se koha në të cilën jetojmë është skepsa më e madhe kundrejt metanarrativave të sajura përgjatë historisë.

Bauman për dallim nga post-modernistët e mësipër, nisat nga ideja se koha moderne me anë të zhvillimit ekonomik dhe teknik-teknologjik ka spostuar (por edhe tejkaluar) edhe marrëdhëniet sociale dhe hapësirën sociale në kushtet e sotme të globalizmit. Po ashtu, me anë të një ndryshimi të tillë, tërësia e fenomenologjike e jetesës sociale, e servuar përmes zhvillimit teknologjik bën dominimin e sferës psikologjike në kuptim të presionit të hapësirës sociale dhe psikologjike në atë që Bauman e quan “lufta e hapësirës” (space-wars). Në fakt, në analizë të mëtejme të mbraujtes psikologjike në kushtet e globalizmit, Bauman shpreh se globalizimi si fenomen i përgjithshëm, ka arritur të bëjë “diferencimin” e realitetit të subjekteve, po edhe kuptimësisë së gjësëndeve dhe diturisë së trashëguar mbi to. Diferencimi natyrisht flet për një ndryshim ontologjik të sferës psiko-filozofike të qenies njerëzore, kur edhe instancat e realitetit nuk mbajnë karakterin vertikal (siçp.sh. në traditën metafizike) por në “zhvendosjet” horizontale, që për pasojë jep dekonstrukcionizmit semantik të kuptimësive të gjësëndeve po edhe të vetë subjektit. E përpunuar gjërë e gjatë kjo temë nga vetë postmodernistët (Lyotard, Derrida), për interesa të punimit tonë ne mbështetemi në atë që Bauman e sheh këtë zhvendosje si temë e natyrës “fluide” moderne, e cila ndihmon që të dy sindromate jetesës moderne: panoptikon dhe sinoptikon.

¹⁹⁴ Aristotel, *Organon*, Beograd, Kultura (1965)

Paraqitja dikotomke e sindromës së panoptikonit dhe sinoptikonit, te Bauman flet parasegjithash për rekonceptualizimin e hapësirës sociale. Ndërsa e para, i nënshtron subjektet në atë që “të shihen”, e dyta sipas Bauman i ushqen subjektet të bashkohen në atë “të shohin”. Derisa te rasti i parë subjektet “zhvendosen” në veprimin pasiv “që të vëzhgohem”, të dytët marrin karakterin aktiv “të bashkohemi procesin e të të vëzhguarit”. Madje sipas Bauman, zhvillimi institucional-shoqëror dhe shkencor-teknologjik, panoptikonit e përdori për të imponuar imobilitetin në sferën shoqërore, si kur shprehet se “panoptiku kur ishte universal në aplikimin e tij .. parimet e tij përfaquan pjesën më të madhe të popullsisë, ishte pra për nga natyra një krijim lokal - gjendja dhe efektet e institucionit panoptik ishin imobiliteti i subjekteve të tij - mbikëqyrja ishte atje për të kapur ose të paktën për të parandaluar lëvizjet autonome, të kushtëzuara dhe të çrregullta”¹⁹⁵. Nga ana tjetër sinoptikoni ka natyrë universale për nga aspekti i bindjes së përbashkësimit të procesit të të vëzhguarit në një sferë “të përbashkët” shtresore të shoqërisë, pra i “transporton vëzhguesit, së paku shpirtërisht, në një hapësirë kibernetike (cyber-space)”¹⁹⁶. Që të dy sindromat e globalizimit sipas Bauman janë prodhuar nga faktorë të ndryshëm të zhvillimit institucional por edhe politik, arkitekturor, ideologjik etj, i të cilëve qëllim ishte të zhvendosin disa nga paradigmat kuptimore në shoqërinë njerëzore. Në këtë kuptim, vetëm të marrim shembullin e “qytetit të qelqtë” të Bauman do të mundnim të zhytemi në sqarimin e mesipërm të zhvendosjeve estetike të jetesës njerëzore. Në këndvështrimin estetik, me shembullin e “qytetit të qelqtë”, Bauman i referohet të njëjtit sindrom të gjithëpresencës. Estetikisht, globalizimi ka rikoncipuar edhe hapësirën tonë të qyteteve. Privatësia siç ishte koncipuar para revolucioneve të teknologjisë është larg asaj që ka njerëzimi sot. Jeta e njerëzve është gjithëherë e “përbashkët”, dhe ajo ndodh “tani” dhe “këtu”. Arkitektura e qyteteve moderne, poaq është një nga efektet e këtij sindromi omnipezent dhe pan-transparent, që sipas Bauman e shohim përgjatë qyteteve moderne. Estetika në këtë rast urbane, e bën për të menduar atë që influencat e panoptikonit dhe sinoptikonit bëjnë në vetë filozofinë estetike të jetesës njerëzore, dhe që globalizimi i ka përbashkësuar ato.

4.NOMADIZMI MODERN I BAUMAN: DUKE DEKOMPOZUAR KOHËN DHE HAPËSIRËN

Përveç sferës estetike, ndikimet e së cilës janë të dukshme në qytetet moderne, një nga shtresimet e tjera të cilat i numëron Bauman (dhe që lidhen me sindromat e lartpërmendura të sinoptikonit dhe panoptikonit) është paraqitja e fenomenit të dekompozimit të kohës dhe hapësirës, si dhe ngritjes së “stratifikimeve” të reja sociale në kushtet e sotme globaliste, siç janë: turistët dhe vagabondët. Të parët, pra turistët, janë klasa e njerëzve që jetojnë “ashtu siç dëshirojnë”, ndërsa të dytët “ashtu siç ju imponohet të jetojnë”¹⁹⁷. Ndërsa kategoria e parë kënaqet në endjet dhe përçatjet botërore, të dytët përbëjnë klasën të cilën poaq përçarten si turistët, por në botën e palëvizshmërisë. Të parët, pra turistët kanë dekompozuar hapësirën meqë gjithëprania e tyre iu ka humbur kuptimin hapësiror, ndërsa vagabondët kanë dekompozuar kohën, meqë imobiliteti i tyre ka zhvendosur kuptimin e kohës dhe ka krijuar standardin e gjithkohshmërisë, pra përjetësisë.

Dy nga stratat siç përshkruhen, përbëjnë stratifikimin e ri të shoqërisë globale. Në shembullin e përmendur te Baumankuptojmë se turisti është nomadi ndaj të cilit hapësira nuk është sfida e tij, dhe as kategori e pranishme për ta “kapërcyer”, pasi prania e tij është pothuajse kudo, pra gjithkund. Për më tepër, “ky lloj i kulturës .. nuk është kulturë e një vendi të caktuar; është kultura e një kohe. Është një kulturë e pranisë absolute”¹⁹⁸. Prania absolute këtu i referohet një gjendjeje të një subjekti që shpërndanë prezencat hapësirore në instancat gjithëpranishmërisë, prandaj, hapësira kundrejt një gjendjeje të tillë, nuk ka më kuptim, porse vetëm kategoria e kohës i përbën vlerën e vetme. Përsëri, strata e turistëve nuk kanë shtëpi, por nuk janë të pa strehë, ose thënë ndryshe: dematerializojnë hapësirën pa e ekspozuar veten në shqetësimet dhe ankthet e pastrehësisë. Nomadizmi në këtë kontekst mund të quhet modern. Bauman, në analizë të mëtejme, definon nomadizmin modern për dy stratat e globalizimit. Për të parin, pra turistët, nomadizmi është i vullnetshëm, ndërsa për klasën e dytë, pra për vagabondët, nomadizmi është sipas imponimit në vullnetin e subjekteve. Ose, edhe njëherë, strata e parë përbëjnë ato nomadët luksos, kurse të dytë ato asketik. Kjo e fundit, për shkak të imobilitetit dhe pamundësisë për rihapësirim (së këndejmi edhe të rikohërimit në pakohë) merr konotacionin e stratës postmoderne të skllavërisë¹⁹⁹.

Kur bëhet fjalë për stratën e dytë, pra vagabondet, janë ato subjekte që në pamundësinë e lëvizshmërisë së tyre hapësirore, gjenden e të cilëve e ka imponuar agjenda e turistëve, dhe kanë zgjedhur të ndajnë kohën e tyre me botën njëhapësirore. Në fakt, këto i janë kushtuar shërbimeve turistike të filozofisë së jetës së udhëhequr nga vetë

¹⁹⁵Bauman, Z. *Globalization: Human Consequences*, Oxford, Polity Press (1998), f. 52

¹⁹⁶ Ibid.

¹⁹⁷ Ibid., f.93

¹⁹⁸ Ibid., f.90

¹⁹⁹ Ibid., f. 92

strata e turistëve, që në fomrë simbolike Bauman i përshkruan si “hëna të errëta të cilët për refleksion kanë zgjedhur vetëm shkëlqimin e diellit turistik (pra të klasës turisitke)...për më tepër këto janë mutantët postmodern të evolucionit”²⁰⁰. Të a.q. mutant postmodern mbajnë kuptimin e gjendjes së subjekteve të tjetërsuar nga formatet dhe instancat e jetesës në kohë dhe hapësirë “klasike”, dhe që kanë instancuar horizontalisht veten në dekonstruimin e koncepteve abstrakte që lidhen me kuptimësitë mbi kohën dhe hapësirën, si në jetën sociale po edhe në atë individuale.

Duke marrë në konsideratë këto më lart, kuptimet që referon Bauman për stratat moderne dhe karakteristikat e tyre, përmbledhet në idenë se globalizimi ka prekur në mënyrë holistike jetën njerëore. Për më tepër ri-paradigmatizimet e reja të stilit të jetesës dhe statusin psikologjik të subjekteve janë disa nga dëshmitë e influencat dhe konsekuencat e globalizimit. Të dyja stratat janë praktikisht të pozicionuara dhe të shtresuara. E para është në çdo hapësirë, pra nuk ka hapësirë, derisa e dyta në çdo kohë, pra jeton në pa-kohë. Zhvendosja e këtyre “atributeve”jetike do të thotë të ndryshosh kuptimin tradicional të vlerave thelbësore shoqërore.

4. KONKLUZA

Punimi ynë kishte për synim të paraqes një nga ridimensionimet shoqërore dhe të qenies njerëzore të shkaktuara nga procesi i globalizimit në botë. Aspektet të cilat preku punimi ynë ishin të natyrës së diskursit filozofik meqë diskutuam mbi re-paradigmatizimet e koncepteve të ndjeshme të jetesës njerëzore, siç ishin çështja e kohës dhe hapësirës. Në të dy kategoritë u panë qëqenia njerëzore dhe shoqëritë të kenë ripozicionuar qëndrimet lidhur me to, dhe së këndejmi të implikohen në pasoja të zhvendosjeve tjera të jetesës dhe konceptimit të shoqërisë. Në diskutimet e shumta mbi globalizimin, u zgjodh si shembull filozofi dhe sociologu Zygmunt Bauman, i cili nga qëndrimet e veta mbi konsekuencat e globalizimit dha një kontribut të madh nëkonceptimin e efekteve të globalizimit në botë, parë këto me një finesë të thuktë socio-filozofike. Temat që i trajtuam nga autori këtu si: stratifikimet moderne, sindroma panoptikon dhe sinoptikon, kompresimi i kohës dhe hapësirës, “qyteti i qelqtë” dhe të tjera, na bëjnë me dije se për dallim nga shumica e vështrimeve dhe fushave të analizës mbi globalizimin, Zygmunt Bauman dha një qasje të re, që në mendimin tonë mund të quhet qasje meta-paradigmatiste.

BIBLIOGRAFIA

- [1] Aristotel, Organon, Beograd, Kultura, 1965.
- [2] A. Anxaku, Arsyeja ndërmjet mitit, iluminizmit dhe refleksionit kritik, Tiranë: Maluka, 2007.
- [3] Z. Bauman, Globalization: Human Consequences, Oxford: Polity Press, 1998.
- [4] Z. Bauman, Liquid Modernity, Cambridge: Polity Press, 2000.
- [5] J.A. Scholte, Globalization – A Critical Introduction (2nd Edition), NY: Palgrave Macmillan, 2005.
- [6] J.F. Lyotard, Kushti Postmodern – Raport mbi Situatën e Dijes, Tiranë: ISP & Edlora, 2011.

²⁰⁰ Ibid.